



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L - 039

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-029 PËR
PATENTA**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-029 PËR
PATENTA**

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit bazik, pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2 me tekstin si në vijim:

2. Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivat:

2.1 Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 6 korrik 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike OJ L213 f13, 1998/07/30;

2.2 Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (OJ L 157, f.45,2004/04/30 OJ L 195, F.16,2004/02/06;

2.3 Rregullorja (EC) Nr. 469/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 6 maj 2009 në lidhje me çertifikatën e mbrojtjes shtesë për produktet medicinale (O.J.L. 152, f.1, 2009/06/16;

2.4 Rregullorja (EC) Nr.1610/96 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 korrik 1996 lidhur me krijimin e një çertifikate të mbrojtjes shtesë për produktet për mbrojtjen e bimëve (O.J. L 198,f.30,1996/08/08);

2.5 Rregullorja (EC) Nr. 816/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 17 maj 2006 për licencimin e detyrueshëm të patentave lidhur me prodhimin e produkteve farmaceutike për eksport në vend me probleme të shëndetit publik (O.J.L 157,f.1,2006/06/09).

Neni 2

1. Në nenin 2 të ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. fshihet, si dhe në tërë tekstin e Ligjit bazik emërtimi “Zyra e pronësisë industriale” (ZPI) - zëvendësohet me emërtimin Agjencia për Pronësi Industriale tani e tutje (API).

2. Në nenin 2 të ligjit bazik, nënparagrafi 1.5 fshihet.

Neni 3

Në nenin 4 të ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 2 riformulohen me tekstin si në vijim:

1. API është organ qëndror administrativ i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe është përgjegjës për mbrojtjen ligjore të shpikjes, markës tregtare, dizajnit industrial, emërtimit të origjinës, treguesve gjeografik dhe topografive të qarqeve të integruara, si dhe çështjet e tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës.

2. Organizimi dhe funksionimi i API-së rregullohet me akt nënligjor.

Neni 4

Neni 5 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 5 Përgjegjësitë e Agjencisë

1. Agjencia është përgjegjëse për:

1.1 Zhvillimin e procedurave për lëshimin e patentave, çertifikatave suplementare të mbrojtjes së shpikjes, regjistrimin e markave tregtare, dizajneve industriale, topografite e qarqeve të integruara, emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografik;

1.2 Përpilimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përcaktuar me Ligjin bazë;

1.3 Propozon, harton dhe publikon Buletinin Zyrtar të API-së, që përmbanë të dhëna për aplikimin dhe të drejtat e dhëna për pronësinë industriale;

1.4 Kontribon, zhvillon dhe promovon mbrojtjen e pronësisë industriale;

1.5 Inicon dhe propozon ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale;

1.6 Ofron shërbime informuese lidhur me objektet e pronësisë industriale;

1.7 Organizon testimin për përfaqësues të autorizuar në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;

1.8 Përgatit propozime për miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e pronësisë industriale;

1.9 Bashkëpunon me organet tjera në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë pronësinë industriale;

1.10 Përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare për pronësinë industriale.

Neni 5

1. Në nenin 6 të ligjit bazik paragrafi 4 riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative, kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 6

Në nenin 9 të ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 ndahet në dy nënparagrafë 1.2.a dhe 1.2.b me tekstin si në vijim:

1.2.a Varietetet bimore dhe shtazore;

1.2.b Procese thelbësisht biologjike për prodhimin e bimëve ose shtazëve, pa paragjykuar patentueshmërinë e shpikjeve, që lidhet me një proces mikrobiologjik ose proces tjetër teknik, apo me një produkt të përfituar me anë të një procesi të tillë.

Neni 7

Në nenin 24 të ligjit bazik, paragrafët 1, 2 dhe 3 fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Nëse materiali biologjik i cili përmban karakteristika specifike si rezultat i shpikjes është i mbrojtur me patentë, atëherë të drejtat ekskluzive të cekura në nenin 23 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit bazik, zbatohen edhe për çdo material biologjik që rrjedh nga materiali tjetër biologjik nëpërmjet përhapjes ose shumëzimit në një formë identike ose divergjente dhe që posedon karakteristika të njëjta.

2. Nëse procesi që mundëson prodhimin e materialit biologjik që përmban karakteristika specifike si rezultat i shpikjes është i mbrojtur me patentë, atëherë të drejtat ekskluzive të cekura në nenin 23 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit bazik zbatohen edhe tek materiali biologjik që fitohet direkt nga materiali tjetër biologjik nëpërmjet përhapjes ose shumëzimit në formë identike apo divergjente dhe që posedon karakteristika të njëjta.

3. Nëse një produkt që përmban ose përbëhet nga informatat gjenetike është i mbrojtur me patentë, atëherë të drejtat ekskluzive të cekura në nenin 23 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit bazik zbatohen për gjithë materialin, përveç trupit të njeriut dhe fazave të ndryshme të formimit dhe zhvillimit ose zbulimit të thjeshtë të njërit prej përbërësve të tij, përfshirë sekuencën ose një pjesë të sekuencës së gjenit, ku përfshihet produkti dhe në të cilin gjenden informatat gjenetike dhe që realizojnë funksionin e tyre.

Neni 8

Në nenin 36 të ligjit bazik, paragrafi 4 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Në bazë të kërkesës së arsyetuar gjykata mund t'i jap licencë të detyrueshme për patentën e parë, pronarit të patentës ose pronarit të të drejtave për varietetet bimore, i cili nuk mund të shfrytëzoj patentën e tij, patentën e dytë ose të drejtën për varietetin bimor, pa e shkelur patentën e parë ose të drejtën e mëhershme për varietetet bimore me kusht që shpikja e pretenduar për patentën e dytë ose varietetin e mbrojtur bimor, të përfshijë avancim të rëndësishëm teknik të një rëndësie të konsiderueshme ekonomike, në raport me shpikjen e pretenduar në patentën e parë.

Neni 9

1. Në nenin 63 të ligjit bazik, paragrafi 3 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Aplikacioni i mëvonshëm për patentë që është dorëzuar në të njëjtin ose për të njëjtin shtet, konsiderohet si aplikim i parë, për nevoja të përcaktimit të së drejtës së përparësisë, në pjesën që ka të bëjë me lëndën e shpikjes së aplikacionit të parë, nëse në datën e dorëzimit të aplikacionit të mëvonshëm, aplikacioni i parë që ka shërbyer për përcaktimin e të drejtës së përparësisë, është tërhequr, refuzuar ose hedhur poshtë para se të jetë bërë e njohur për publikun dhe pa lënë asnjë të drejtë të pazgjidhur e

cila mund të mos ketë shërbyer si bazë për të pretenduar të drejtën e përparësisë. Aplikimi i parë për patentë nuk mund të shërbejë më si bazë për kërkesë të së drejtës së përparësisë.

2. Në nenin 63 të ligjit bazik, pas paragrafit 4 shtohet paragrafi i ri 5 me tekstin si në vijim:

5. Kur kopja e aplikacionit të parë e përcaktuar në paragrafin 4.2 të nenit 63 të ligjit bazë nuk është në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, API ose Gjykata kompetente mund të kërkojnë nga personi që ka paraqitur kërkesën për prioritet të sjellë përkthimin e aplikimit të parë në një nga gjuhët zyrtare brenda tre (3) muajve nga dita e pranimit të ftesës.

Neni 10

1. Në nenin 78 të ligjit bazik paragrafi 1, shtohet edhe referimi në nenin 13.

Neni 11

1. Në nenin 80 të ligjit bazik, paragrafi 6 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Rivendosja e të drejtave nuk mund të kërkohet në rast të dështimit të përmbushjes së afateve kohore për veprimet vijuese:

2. Në nenin 80 të ligjit bazik, nënparagrafi 6.3 fshihet në tërësi.

Neni 12

Në nenin 83 të ligjit bazik, paragrafi 5 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Tarifa për mirëmbajtjen e patentës mund të paguhet nga çdo person.

Neni 13

1. Në nenin 84 të ligjit bazik, paragrafi 1 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Shprehjet e përdorura në lidhje me Certifikatën e Mbrojtjes Suplementare kanë këto kuptime:

2. Në nenin 84 të ligjit bazik paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3 Patenta bazë është një patentë e caktuar nga mbajtësi i saj për zhvillimin e procedurës për dhënien e Certifikatës të Mbrojtjes Suplementare, për të mbrojtur produktin si të tillë, siç përcaktohet në nënparagrafin 1.2 të nenit 84 të ligjit bazik apo procesin për të përfituar një produkt apo aplikimin e një produkti;

3. Në nenin 84 të ligjit bazik, paragrafi 2, riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Termat e përdorur në lidhje me Certifikatën e Mbrojtjes Suplementare për produktet në mbrojtjen e bimëve - në tekstin e mëtejme certifikata - kanë këto kuptime:

4. Në nenin 84 të ligjit bazik, paragrafi 2, nënparagrafi 2.9 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

2.9 Patenta bazë është një patentë e caktuar nga mbajtësi i saj me qëllim të zhvillimit të procedurës për dhënien e „Certifikatës së Mbrojtjes Suplementare“, për të mbrojtur produktin si të tillë, siç përcaktohet në nënparagrafin 2.8 të nenit 84 të ligjit bazik, apo përgatitjen e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 84 të ligjit bazik ose procesin për të përfituar një produkt apo për aplikimin e një produkti;

Neni 14

Në nenin 88 të ligjit bazik, paragrafi 1 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Procedura për dhënien e Certifikatës duhet të fillojë me parashtrimin e një aplikacioni i cili përmban:

1.1 Kërkesën për dhënien e Certifikatës, e cila në veçanti përcakton:

1.1.1 Emrin dhe adresën e aplikuesit;

1.1.2 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse ka të tillë;

1.1.3 Numrin e patentës bazë dhe titullin e shpikjes;

2. Në nenin 88 të ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 rinumërohet si nënparagrafi 1.1.4, nënparagrafi 1.5 rinumërohet si nënparagrafi 1.2 dhe nënparagrafi 1.6 rinumërohet si 1.3, nënparagrafi 1.7 rinumërohet si 1.4, nënparagrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3 Dëshminë që tregon identitetin e produktit, përmbajtjen e procedurës së autorizimit dhe Buletinin në të cilin është publikuar informacioni lidhur me autorizimin, nëse autorizimi i referuar në nënparagrafin 1.2 të këtij neni nuk është autorizim i parë për vendosjen e produktit në treg.

3. Në nenin 88 të ligjit bazik, paragrafi 4, nënparagrafi 4.2. fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

4.2 kur është e domosdoshme, përveç kopjes së autorizimit për të vendosur produktin në treg, siç është e përcaktuar në paragrafët 1.2 të nenit 88 të ligjit bazik, mund të kërkohet edhe dëshmia e posedimit të autorizimit për vendosjen e produktit në tregun e të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

4. Në nenin 88 të ligjit bazik, paragrafët 5, 6 dhe 7 fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

5. Kur aplikacioni për certifikatë është në fazën e ekzaminimit, kërkesa për kohëzgjatje të afatit në pajtim me paragrafin 2 të nenit 87 të ligjit bazik, duhet t'i përfshijë të dhënat e përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 88 të ligjit bazik dhe një referencë për aplikimin për certifikatë, tashmë të dorëzuar.

6. Kërkesa për kohëzgjatje të afatit të certifikatës në fjalë duhet t'i përfshijë të dhënat e përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 88 të ligjit bazik si dhe kopjen e certifikatës tashmë të lëshuar.

7. Kërkesa e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, neni 88 i ligjit bazik, duhet të dorëzohet në formën dhe përmbajtjen e cila duhet të përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 15

Në nenin 93 të ligjit bazik, paragrafet 1 dhe 2 fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Brenda kufijve të mbrojtjes që e siguron patenta bazë, mbrojtja e dhënë nga „Certifikata Suplementare për Mbrojtje“ duhet të kufizohet vetëm për produktin e mbuluar nga autorizimi për të vendosur në treg një produkt medicinal të dedikuar për njerëzit apo kafshët, përkatësisht për mbrojtjen e bimëve, si dhe për çdo përdorim të produktit si produkt medicinal të dedikuar për njerëzit apo kafshët, përkatësisht për mbrojtjen e bimëve, që është autorizuar para skadimit të „Certifikatës Suplementare për Mbrojtje“.

2. Certifikata Suplementare për Mbrojtje“ duhet t'i sigurojë pronarit të patentës bazë ose pasardhësit të tij ligjor të drejtat e njejta që sigurohen nga patenta bazë dhe kjo certifikatë do t'i nënshtrohen kufizimeve dhe obligimeve të njejta.

Neni 16

Neni 94 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 94

API publikon të dhënat lidhur me aplikacionin për „Certifikatë Suplementare për Mbrojtje, vendimin për dhënien e kësaj certifikate, ose të dhënat në lidhje me refuzimin e aplikacionit për certifikatë. Të dhënat lidhur me aplikacionin për

vazhdimin e Certifikatës Suplementare për Mbrojtje dhe për ndërprerjen e saj përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 17

Në nenin 96 të ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafit 1.2, i shtohet edhe referimi në nenin 99.

Neni 18

1. Në nenin 102 të ligjit bazik paragrafi 1.3 fshihet në tërësi.
2. Në nenin 102 të ligjit bazik, nënparagrafi 1.4 rinumërohet si nënparagrafi 1.3.

Neni 19

Neni 110 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 110

Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e të drejtave

Mbrojtja e të drejtave nga ky ligj mund të kërkohet nga mbajtësi i së drejtës së patentës, ose nga një person i autorizuar nga mbajtësi i së drejtës në pajtim me dispozitat e përgjithshme të përfaqësimit, dhe nga mbajtësi i licencës ekskluzive, për atë sa ai e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes në bazë të një transaksioni juridik ose ligjit.

Neni 20

Titulli i nenit 112 të ligjit bazik dhe paragrafi 1 i këtij neni fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

Neni 112

Kërkesa përshkak të shkeljes së të drejtës së shpikësit për t'u përmendur si i tillë në aplikacion

1. Shpikësi duhet të ketë të drejtë të paraqesë një kërkesë për të kërkuar që emri i tij të përmendet në aplikacionin për patentë, si dhe/ose në dokumentet që kanë të bëjnë me patentën dhe/ose në regjistrat e API-së, në qoftë se personi i përmendur si i tillë nuk është shpikësi ose në qoftë se shpikësi nuk është përmendur.

Neni 21

1. Në nenin 113 të ligjit bazik , paragrafi 2 ndryshohet referimi, nga neni 25 në nenin 24.

2. Në nenin 113 të ligjit bazik, paragrafi 4 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Padia e cekur në nenin 113 të ligjit bazik, mund të paraqitet kundër ndërmjetësve, shërbimet e të cilëve janë përdorur nga një palë e tretë për të shkelur, apo kërcënuar për të shkelur patentën.

Neni 22

1. Në nenin 114 të ligjit bazik, paragrafi 1, fjala “akteve” zëvendësohet me fjalën “të drejtave”, fjalia “me shpenzimet të shkelësit” fshihet.

2. Në nenin 114 të ligjit bazik paragrafi 2 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Gjykata urdhëron masat e cekura në paragrafin 1, të nenit 114 të ligjit bazik, të mbulohen me shpenzime të shkelësit, përveç nëse ka arsye të veçanta për të mos vendosur kështu.

Neni 23

Në nenin 115 të ligjit bazik, paragrafët 1, 2 dhe 3, fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Pronari i patentës ka të drejtë të parashtrojë padi kundër çdo personi i cili me vetëdije, ose me baza të arsyeshme për të ditur, është angazhuar në kryerjen e pa autorizuar të ndonjërës prej të drejtave të cekura në nenin 23 dhe nenin 24 të ligjit bazik, duke pretenduar dëmet sipas rregullave të përgjithshme mbi zhdëmtimin ligjor të përcaktuara në Ligjin për Marëdhëniet Detyrimore.

2. Pronari i patentës ka të drejtë të parashtrojë padi kundër çdo personi i cili, me vetëdije ose me baza të arsyeshme për të ditur, është angazhuar në ushtrimin e pa autorizuar të ndonjërës prej të drejtave të cekura në nenin 23 dhe nenin 24 të ligjit bazik, duke pretenduar pagesën e shpërblimit në shumën që ai do të kishte marrë, duke marrë parasysh rrethanat, në marrëveshjen e licencës, nëse është lidhur.

3. Pronari i patentës ka të drejtë të parashtrojë padi kundër çdo personi i cili me vetëdije, ose me baza të arsyeshme për të ditur, është angazhuar në ushtrimin e paautorizuar të ndonjërës prej të drejtave të cekura në nenin 23 dhe nenin 24 të ligjit bazik, duke mos pasur bazë për këtë në asnjë transakcion ligjor, vendimit të gjykatës ose ligjit duke pretenduar kompensimin ose kthimin e përfitimeve të tilla sipas

rregullave të përgjithshme mbi pasurimin e pabazë, të përcaktuar në Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore.

Neni 24

Në nenin 119 të ligjit bazik paragrafi 2, nënparagrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

2. Kërkesa e arsyetuar dhe proporcionale sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të paraqitet në formë padie ose të masave të përkohshme kundër shkelësit të pretenduar dhe/ose ndonjë personi tjetër:

2.1 kundër të cilit është ngritur padi sipas paragrafit 1 të këtij neni;

2.2 të cilit i janë gjetur në posedim produkte për të cilat ekziston dyshimi se kanë shkelur patentën në nivel tregtar;

2.3 i cili është gjetur duke ofruar shërbime, të cilat dyshohet se e shkelin patentën në nivel tregtar;

2.4 i cili është gjetur se në nivelin tregtar ofron shërbime të përdorura në aktivitetet që shkelin patentën;

2.5 është i paraqitur nga ndonjë person i referuar në nënparagrafet 2.1, 2.2, 2.3 ose 2.4 të këtij neni si i përfshirë në prodhimin, përgatitjen ose shpërndarjen e mallrave ose ofrimin e shërbimeve.

Neni 25

Në nenin 120 të ligjit bazik, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

1.1 të urdhërojë palën kundërshtuese të ndërpresë, respektivisht të tërhiqet nga aktet që përbëjnë shkelje të patentës, urdhri i tillë gjithashtu mund të nxirret edhe kundër ndërmjetësit, shërbimet e të cilit janë duke u përdorur nga një palë e tretë për ta shkelur një patentë;

1.2 të urdhërojë ndalimin ose heqjen nga tregu të mallrave të dyshuara për shkelje të patentës, ta parandalojë hyrjen ose lëvizjen e tyre brenda kanaleve të tregtimit.

2. Në neni 120 të ligjit bazik, paragrafët 4 dhe 5 fshihet dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

4. Masat e përkohshme sipas paragrafit 1 të nenit 120 të ligjit bazik mund të urdhërohen pa e informuar palën kundërshtuese, nëse paditësi e dëshmon se masat

tjera nuk do të ishin efektive, ose që çdo vonesë do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm. Nëse masat e përkohshme do të urdhërohen pa e informuar palën kundërshtuese, palët duhet për këtë të informohen menjëherë, e më së voni pas ekzekutimit të masave. Rishikimi, përfshinë të drejtën për t'u dëgjuar, e cila bëhet me kërkesë të palës kundërshtuese me qëllim që brenda një afati të arsyeshëm pas njoftimit për marrje të masave, pa marrë parasysh se ato masa duhet të ndryshohen, tërhiqen apo konfirmohen.

5. Në vendimin me të cilin urdhërohet masa e përkohshme, gjykata e cakton kohëzgjatjen e masës së tillë dhe nëse masa është urdhëruar para fillimit të procedurës, afatin brenda të cilit paditësi për masa duhet të parashtojë një kërkesë për të arsyetuar masën, afat ky i cili nuk duhet të kaloj periudhën prej njëzet (20) ditë pune apo tridhjetë e një (31) ditë kalendarike, nga data e komunikimit të vendimit tek paditësi për marrje të masave, cilido afat që është më i gjatë.

3. Në nenit 120 të ligjit bazik pas paragrafit 5 shtohen dy paragraf të ri 6 dhe 7 me tekstin si në vijim:

6. Gjykata mundet që lidhur me masat e përcaktuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 120 të ligjit bazik, të kërkojë nga pronari i patentës që të sigurojë prova të disponueshme e të arsyeshme për të vërtetuar një shkallë të mjaftueshme të sigurisë që ai/ajo është pronari i së drejtës dhe se e drejta e tij/saj është duke u shkelur, ose që shkelja e tillë është e pashmangshme.

7. Kur masat e përkohshme revokohen ose kur ato skadojnë për shkak të një veprimi ose mosveprimi nga ana e paditësit, apo ku më pas është konstatuar se nuk ka pasur shkelje apo kërcënim të shkeljes së patentës, me kërkesë të kundërshtuesit gjykata mund ta urdhërojë paditësin që t'ia ofrojë të paditurit kompensimin përkatës për çdo dëmtim të shkaktuar nga këto masa.

Neni 26

Neni 121 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 121

Masat e përkohshme për ruajtjen e dëshmisë

1. Në padinë e pronarit të patentës, i cili vërteton se patenta e tij është shkelur apo kërcënohet që të shkelet, si dhe që ekziston mundësia se dëshmia për shkeljen në fjalë apo kërcënimin, nuk mund të merrej ose mund të bëhet më e vështirë marrja e saj, gjykata mund që edhe para fillimit të procedurës për vendosjen meritore të rastit, të urdhërojë një masë të përkohshme për ruajtjen e dëshmisë me qëllim të mbrojtjes së informatave konfidenciale.

2. Përmes masave të përkohshme nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata mund të urdhërojë:

2.1 një përshkrim të detajuar të mallrave dhe shërbimeve, që dyshohet se mund të shkelin patentën, me ose pa marrjen e mostrave;

2.2 konfiskimin e mallrave që dyshohet se mund të shkelin patentën;

2.3. konfiskimin e materialeve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave që shkelin një patentë si dhe dokumentet në lidhje me të.

3. Masat e përkohshme të cekura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, mund të urdhërohen pa u dëgjuar pala kundërshtuese, nëse paditësi që kërkon marrjen e masave të përkohshme demonstroi se ekziston rreziku që ndonjë vonesë është e mundshme të shkaktojë dëm të pariparueshëm për pronarin e së drejtës apo kur demonstron se ekziston një rrezik i shkatërrimit të dëshmvive.

4. Nëse një masë e përkohshme është urdhëruar pa u dëgjuar pala kundërshtuese, palët do të informohen menjëherë, më së voni pas ekzekutimit të masave. Një rishikim, përfshirë edhe të drejtën për t'u dëgjuar, do të bëhet me kërkesën e palës kundërshtuese me qëllim të vendosjes, brenda një afati të arsyeshëm pas informimit për masat e përkohshme, pa marrë parasysh nëse ato masa do të ndryshohen, revokohen apo konfirmohen.

5. Në vendimin me të cilin urdhërohet një masë e përkohshme, gjykata vendos për kohëzgjatjen e masës së tillë, dhe nëse masa është urdhëruar para procedurës, afati brenda të cilit paditësi që kërkon masat e përkohshme paraqet kërkesë që të arsyetojë marrjen e masës, afat ky i cili nuk duhet të kalojë periudhën njëzet (20) ditë pune dhe jo më shumë se tridhjet e një (31) ditë kalendarike, nga data e komunikimit të vendimit për paraqitësin e marrjes së masave, cilido afat që është më i gjatë. Nëse një kërkesë nuk paraqitet brenda afatit, masa e përkohshme revokohet.

6. Gjykata duhet të ketë autoritetin të urdhërojë që masat për ruajtje të dëshmvive të jenë objekt i shkresës së paditësit për siguri adekuate apo një siguri ekuivalente me qëllim të sigurimit të kompensimit për ndonjë paragjykim të deklaruar nga mbrojtësi siç është cekur në paragrafin 7 të këtij neni.

7. Kur masat e përkohshme për ruajtje të dëshmvive janë revokuar apo kur ato janë ndërprerë për shkak të mosveprimit nga paraqitësi i kërkesës, apo kur si pasojë është gjetur se nuk ka pasur shkelje apo kërcënim për shkelje të një patente, gjykata mund të urdhërojë për paraqitësin e kërkesës, me kërkesë të kundërshtuesit, që t'i ofrojë të paditurit kompensim adekuat për ndonjë dëm të shkaktuar nga marrja e atyre masave.

Neni 27

Në nenin 122 të ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 2 fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:

Neni 122
Marrja e dëshmive gjatë procedurës

1. Kur një palë në procedurë ka paraqitur dëshmi të arsyeshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e veta që i përkasin palës kundërshtuese apo janë në zotërim të palës kundërshtuese dhe i specifikon ato dëshmi, gjykata do të urdhërojë palën kundërshtuese që të prezantojë dëshmitë e tilla brenda një afati të caktuar, me qëllim të mbrojtjes së informatave konfidenciale.

2. Kur pronari i një patente si paditës në procedurë pretendon se shkelja e një patente është kryer në nivel tregtar me qëllim të arritjes së përfitimeve ekonomike ose komerciale, dhe ka bërë të dyshohet gjatë procedurës si dhe kur ai specifikon në procedurë se dokumentet bankare, financiare apo ekonomike, letra apo dëshmi të ngjashme, duke kërkuar që ato i përkasin palës kundërshtuese apo janë në zotërim të palës kundërshtuese, gjykata do ta ftojë palën kundërshtuese që të prezantojë dëshmitë e tilla brenda një afati të caktuar kohor, me qëllim të mbrojtjes së informatave konfidenciale.

Neni 28

Neni 128 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 128

1. Përfaqësuesi i patentave ka të drejtë t'i përfaqësoj palët në procedurë në lidhje me dhënien dhe mirëmbajtjen e patentave dhe certifikatave të mbrojtës suplementare në pajtim me Legjislacionin në fuqi për patenta.

2. Përfaqësuesi i patentave mund të jetë:

2.1 Personi fizik, shtetas i Republikës së Kosovës me banim të përhershëm në Republikën e Kosovës, me studime të përfunduara universitare dhe i cili e ka të dhënë provimin kualifikues për përfaqësues të patentave në API;

2.2 Personi juridik, që e ka selinë dhe biznesin të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe që punëson së paku një person i cili plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -039
31 korrik 2015

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI